



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim**

Legjislatura e III-të
Nr. 01/08
Prishtinë, më 5.03.2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës,
salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Kosara Nikolić,
Sadik Idriz, Numan Balić, Hafize Hajdini, Hetem Arifi, Zylfi Merxha, Mursejl
Haljilji, Enis Kervan, Xhevdet Neziraj.**

Anëtarët jo të pranishëm: Bojan Stojanoviq, Zafir Berisha .

Gjithashtu të pranishëm ishin: moniturues nga OSCE, KDI.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica -Tisma, Arta Hajra, Vilson Ukaj.

Kryesuese: Sanije Aliaj, nënkryetare e parë e komisionit

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Mbledhja konstituive e Komisionit.**
- 3. Të ndryshme**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua si i tillë i propozuar.

2. Mbledhja konstituive e Komisionit

Kryesuesja përshëndeti të pranishmit dhe urojë atyre Pavarësinë e Kosovës me dëshirë që institucionet shtetërore në këtë mandat të jenë më funksionale dhe të miratojnë ligje si dhe të krijojnë mekanizma për zbatimin e këtyre ligjeve në të mirë të gjithë qytetarëve. Ajo në vazhdim foli për rëndësinë dhe objektivat që i ka ky Komision të cilat janë të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Kosovës dhe shprehu besimin se të gjithë anëtarët tashmë i kanë të njohura. Objektivi apo funksioni i parë i punës së këtij Komisioni është vlerësimi i amendamenteve të projektligjeve të shqyrtuara nga Komisioni funksional të cilat kalojnë në këtë funksion. E drejta jonë është të propozojmë amendamente kur vërejmë se ato të propozuara cenojnë interesat e komuniteteve. Objektivi i dytë është mundësia e Komisionit që më vetëiniciativ të propozoj projektligje Kuvendit nga fusha e vet.

Objektivi i tretë është mbikëqyerja e zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi, qoftë nëpërmes Ministrisë për Komunitete apo edhe direkt me vizita në teren. Vizita të tilla kemi bërë edhe në mandatin e kaluar dhe besoj se do të bëhen edhe në këtë mandat. Kryesuesja njoftoj se punën e këtij Komisioni e kanë përcjellur shumë organizata dhe institucione ndërkombëtare, si OSBE-ja, përfaqësuesit e BE-së, përfaqësuesit e UNMIK-ut dhe shprehu besimin se bashkëpunimi do të vazhdoj edhe më tutje. Gjithashtu njoftoi të pranishmit se duhet hartuar plani i punës për të cilën gjë do të kërkoj ndihmën e OSBE-së.

Kryesuesja kërkoj nga anëtarët nëse duan të marrin fjalën.

Sadik Idriz përshëndeti të pranishmit dhe shprehu besimin se anëtarët e këtij Komisioni do të punojnë në harmoni në kryerjen e punëve dhe detyrave që parashtrihen para tyre. Përmendi disa projektligje të Pakos së Ahtisarit të cilat kanë të bëjnë me komunitetet dhe do të procedohen me një procedurë më të shpejtë dhe mundësia e vetme e Komisionit është të jap kontributin përmes përfaqësuesve të këtij Komisioni, të bëjë propozimet në Komisionin Ad hoc. Propozoi që Kryesuesja së bashku me stafin mbështetës të hartojnë një planë pune që do të jetë orientim i punës së Komisionit.

Numan Balić U pajtua se në mandati e kaluar janë arritur disa rezultate gjatë punës së këtij Komisioni por shumë rezultate nuk janë arritur. Vlerësoi të suksesshme vizita që janë bërë brenda dhe jashtë vendit dhe kërkoj që të vazhdohet edhe në këtë mandat. Kërkoj që në këtë mandat të jenë më të suksesshëm. Të krijohet një bashkëpunim më i madh mes Komisionit dhe Organeve të Kuvendit, Kryetarit, Kryesisë, me komisionet tjera i cili nuk ka qenë në nivel të duhur. Bashkëpunimi të jetë me i madh edhe Ministrinë përkatëse, të mbikëqyret puna tyre, një bashkëveprim të vazhdoj edhe me policinë, UNMIK-un dhe me institucionet tjera relevante. Pati vërejtje rreth procedurës së përshpejtuar të procedimit dhe miratimit të projektligjeve dhe kërkoj nga anëtarët të mos përkrahin një praktikë të tillë. Shprehu kritikën e miratimit të shpejt të projektligjeve nga Pakoja e Ahtisarit e në veçanti kërkoj që t'i kushtojnë kujdes Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Kërkoj që Komisioni për komunitete të ketë rolin aktiv në raport me Komisionin ad hoc duke bërë propozime dhe amendamente të cilat duhet merren parasysh, pavarësisht procedurës së përshpejtuar.

Xhevdet Neziraj theksoi së është në mandatin e tretë në këtë Komision dhe shfaqti besimin se në këtë mandat Komisioni do të bëjë një punë më të suksesshme. Propozoi që komisioni të mos miratojë vetëm ligje por edhe të mbikëqyret zbatimin e tyre. Bëri vërejtje rreth vizitave nëpër institucione zbatuese të ligjeve sidomos nëpër komuna të cilat nuk kanë sjellë rezultate konkrete në përmirësimin e kushteve të jetës së minoriteteve që jetojnë aty. Kërkoj që Ministrinë përkatëse të monitorohen dhe të kërkohet llogari prej tyre. Vërejtje pati edhe sa i përket mungesës së punësimit të komuniteteve pakicë në ndërmarrjet publike. Përkrahu mendimin që për projektligjet që dalin nga Pakoja Ahtisarit, rekomandimet e këtij komisioni të përcillen përmes Komisionit ad hoc.

Müferra Şinik përshëndeti të pranishmit dhe shprehu besimin se ky Komision do të punojë më shumë për të mbrojtur të drejtat e komuniteteve që garantohen me ligj. Propozoi që në periudha plani tre mujor në procedimin e ligjeve të zgjatet në mënyrë që mundësohet shqyrtimi dhe plotësimi i këtyre projektligjeve. Kërkoj gjithashtu që njoftimet dhe materialet të bëhen edhe në gjuhën e turke.

Enis Kervan pas fjalës përshëndetëse parashtrori dy pyetje: 1. Vendimet për amendamente apo propozim tjetër a merren me konsensus apo me shumicë votash? 2. Çfarë raporti do të ketë Komisioni ynë me Komisionin ad hoc rreth shqyrtimit të projektligjeve të Pakos së Ahtisarit? z. Kervan propozoi që Komisioni të bëjë vizita të veçanta që të njoftohet me problemet e komuniteteve. Kërkoj që në shqyrtimin e dytë të projektligjeve në Kuvend anëtarët të dëshmojnë unitetin e krijuar nga shqyrtimi i projektligjeve në Komision.

Kosara Nikolić përshëndeti anëtarët dhe theksoi se duke pasur parasysh faktin se është ndër dy Komisionet kryesore, propozoi që të gjitha projektligjet të cilat kalojnë këtu të shqyrtohen me kujdes dhe materialet të i marrim me kohë dhe t'i analizojmë dhe shqyrtojmë ato dhe të japim mendimet dhe rekomandimet e tona.

Hetem Arifi përshëndeti të gjithë. U pajtua me mendimet e deputetit Neziraj sidomos rreth vizitave të Komisionit nëpër komuna të cilat nuk kanë ndryshuar shumë në përmirësimin e jetesës së komuniteteve pakicë. Kërkoj që të jemi më kritik ndaj Ministrive në realizimin e të drejtave të Komuniteteve, por edhe si komision të punojmë më shumë në këtë drejtim.

Kryesuesja përkrahu mendimin se nga vizitat nëpër komuna nuk kanë dhënë rezultatet e dëshiruara në zgjidhjen e probleme të integritetit të komuniteteve por shfaqti shpresën se në këtë mandat do të jenë më këmbëngulës në realizimin e rekomandimeve tona. Sa i përket projektligjeve që dalin nga Pakoja e Ahtisarit dhe krijimit të Komisionit ad hoc theksoi se është miratuar në Kuvend dhe nuk mund të ndryshojmë asgjë në këtë drejtim. Por nëse vërejmë se ndonjë dispozitë e këtyre projektligjeve shkelin të drejtat e komuniteteve ne mund të mblidhemi urgjentisht dhe përmes anëtarëve tonë të propozojmë amendamentet në Komisionin ad hoc.

Mursejl Haljilji përshëndeti të pranishmit. Vlerësoj rëndësinë që këtij Komisioni në të cilin janë të përfaqësuar të gjitha komunitetet dhe duke pasur parasysh rregullën 52.4 dhe 52.5 të Rregullorës së Kuvendit të Kosovës Komision ka karakter konsultativ në fushëveprimin e tij gjatë shqyrtimit të projektligjeve. Prandaj në pajtim me rregullën 49 të Rregullorës së Kuvendit kërkoj që të formohet një nënkomision në mënyrë që të propozoj ndryshimin e procedurës së rregullave në fjalë të cilat rregullojnë procedurat e shqyrtimit të projektligjeve nga ky Komisioni. Në të kundërtën komisioni do të ketë vetëm rolin këshillëdhënës dhe konsultues.

3. Të ndryshme

Kryesuesja parashtrori dy propozime:

1. Të formohet një nënkomision më përbërje të gjithë grupeve të komuniteteve për hartimin e planit tre mujor të punës së Komisionit që do ta bëjnë së bashku më përfaqësuesit e OSBE-së;
2. Të caktohet dita dhe ora për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Komisionit .

Anëtarët u akorduan që si ditë për mbajtjen e mbledhjeve të jetë dita e martë në orën 13:00 pasdite.

Mbledhja përfundoi në ora 12:27

Shërbimi i komisioneve

Kryesuesja e Komisionit

Sanije Aliaj

